

MBESHTETUR NGA



Centar za građansko obrazovanje

Qendra për Edukim Qytetar

IMPLEMENTUAR NGA



ACDC

Advocacy Center For Democratic Culture

**MBËSHTETJE PËR PAJTIM
NË KOSOVË
DUKE NGRITUR VETËDIJEN
PËR ÇËSHTJEN E PERSONAVE TË ZHDUKUR**

ANALIZA E HULUMTIMIT

Prill, 2020.

Rezerva:

Pikëpamjet e shprehura në këtë analizë janë përgjegjësi ekskluzive e Qendrës për Avokimin e Kulturës Demokratike (ACDC) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merren për të pasqyruar pikëpamjet e donatorëve të cilët kanë mbështetur këtë projekt.

Përmbajtja

Konteksti i hulumtimit.....	4
Metodologjia e hulumtimit.....	5
Rezultatet më të rëndësishme	6
Përmbledhja e hulumtimit - Perceptimi i çështjeve kryesore	7
Demografia.....	8
Rezultatet e hulumtimit.....	10
Konkluzionet	29

Konteksti i hulumtimit

Çështja e personave të zhdukur është një nga problemet më të mëdha me të cilat përballen njerëzit në procesin e pajtimit pas konflikteve etnike. Edhe pse kjo temë është jashtëzakonisht e ndieshme, veçanërisht për punën dhe aktivizmin e organizatave të shoqërisë civile, ajo është shumë e rëndësishme dhe e nevojshme në procesin e pajtimit. Në lidhje me këtë, OJQ-ja Qendra për Avokimin e Kulturës Demokratike - ACDC, me mbështetjen e Qendrës për Edukim Qytetar - QEQ, është duke implementuar projektin i cili është pjesë e një projekti më të gjerë me titull "Aktivizmi i sektorit civil për pajtimin në regjionin e ish-Jugosllavisë - Mbështetja KOMRA" i cili do të trajtojë procesin e pajtimit në Kosovë duke rritur ndërgjegjësimin për çështjen e personave të zhdukur.

Qëllimi i projektit është për të mbështetë pajtimin në Kosovë duke rritur ndërgjegjësimin për personat e zhdukur.

Në kuadër të projektit të përmendur, është realizuar një hulumtim që ka për qëllim matjen dhe ngritjen e nivelit të vetëdijësimit të qytetarëve në lidhje me çështjen e personave të zhdukur, si dhe për aktivitetet e realizuara nga ana e KOMRA.

Hulumtimi ka përfshirë një studim të publikut përmes një pyetësoi të anketimit dhe grupeve të fokusit.

Qëllimi është të implementojmë një politikë të bazuar në rezultatet e marra dhe të bëjmë një plan veprimi për të ndihmuar në zgjidhjen e këtij problemi.

Metodologjia e hulumtimit

- Hulumtim sasior -

Metoda e hulumtimit: Hulumtimi në terren i studimit F2F, i kombinuar me studim në internet, si dhe dy grupe të fokusit

Vendi i hulumtimit: Mitrovica Veriore, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok

Koha e hulumtimit: 1. mars - 6. prill 2020.

Madhësia e mostrës: 308 të anketuar gjatë hulumtimit në terren, 210 të anketuar përmes Internetit

Përshkrimi i mostrës: Nga gjithsej 518 të anketuar, 34.3% e të anketuarve ishin meshkuj dhe 65.7% femra

Lloji i mostrës: Mostra e rastësishme përfaqësuese e strukturuar, në bazë të komunës së banimit

Poststratifikimi: Moshë, niveli i arsimimit dhe statusi i punësimit

Rezultatet më të rëndësishme

71.6% të qytetarëve besojnë se çështja e personave të zhdukur diskutohet në mënyrë të pamjaftueshme në publik

55.2% të qytetarëve kurrë nuk kanë dëgjuar për Koalicionin për KOMRA

83.6% të qytetarëve janë njoftuar që ekzistojnë shoqatat e familjeve të të zhdukurve

74.2% të qytetarëve besojnë se deri tani nuk është përcaktuar numri i saktë i personave të zhdukur

84.8% të anketuarve besojnë se është shumë e rëndësishme zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur

71.2% të anketuarve njohin ndonjë person, i afërmi i të cilit është zhdukur gjatë konflikteve të fundit në Kosovë

64% të anketuarve thonë se rastet e dhëna nuk janë sqaruar

57.6% të qytetarëve besojnë se politikanët nuk janë angazhuar në zgjidhjen e rasteve të personave të zhdukur

51.5% të qytetarëve besojnë se as institucionet vendore nuk kanë ndërmarrë masat e nevojshme për të zbuluar fatin e personave të zhdukur

71.6% të qytetarëve besojnë se bashkëpunimi midis palës serbe dhe shqiptare duhet të përmirësohet

67.2% të qytetarëve konsiderojnë se çështja e personave të zhdukur duhet të jetë kryesisht temë diskutimi midis përfaqësuesve të dialogut Beograd-Prishtinë në Bruksel

Përmbledhja e hulumtimit - Perceptimi i çështjeve kryesore


Rezultatet e anketës:

- *Hulumtimi tregoi se informacionet në lidhje me Koalicionin për KOMRA dhe aktivitetet e tyre nuk janë mjaft të njohura për publikun;*
- *Një numër i madh i qytetarëve janë informuar se ka shoqata të familjeve të të zhdukurve, por që kjo çështje nuk është diskutuar në mënyrë të mjaftueshme në publik;*
- *Fatkeqësisht, një numër i madh i të anketuarve njohin njerëz nga mjedisi i tyre të cilëve dikush nga të afërmit i është zhdukur gjatë konflikteve të fundit në Kosovë, ku në të njëjtën kohë pretendojnë se këto raste nuk janë sqaruar;*
- *Shumica e të anketuarve janë të mendimit se as politikanët, as institucionet vendore nuk janë angazhuar sa duhet për të zgjidhur fatin e personave të zhdukur;*
- *Një numër i vogël i të anketuarve besojnë se çështja e personave të zhdukur do të zgjidhet në të ardhmen e afërt pikërisht për shkak të mosbesimit ndaj institucioneve dhe organizatave;*
- *Qytetarët janë të mendimit se çështja e personave të zhdukur duhet të zgjidhet nga përfaqësuesit e dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel.*

Demografia


1. Gjinia

518 responses




2. Mosha

518 responses




3. Komuna (shënoje qytetin)

518 responses



4. Shkollimi


518 responses



- Shkolla fillore e papërfunduar
- Shkolla fillore e përfunduar
- Shkolla fillore e përfunduar
- Studimet themelore (në vazhdim)
- Studimet themelore (të përfunduara)
- Studimet postdiplomike (në vazhdim)
- Studimet postdiplomike (të përfunduara)

5. Përkatësia etnike


518 responses



- Shqiptarë/are
- Boshnjak/ake
- Goran/ane
- RAE
- Serb/e
- Turk/e
- American

6. Statusi i punës


518 responses



Rezultatet e hulumtimit

7. A jeni të informuar për çështjen e personave të zhdukur në Kosovë dhe në çfarë mënyre?

518 responses




Për shumicën e qytetarëve të anketuar, 53.7% e tyre, medijat janë burimi kryesor i informacionit për personat e zhdukur, dhe 32.8% e tyre janë informuar përmes Internetit. Një përqindje më e vogël e të anketuarve thonë se nuk janë të informuar për këtë temë, dhe, nga ana tjetër, ka nga ata që tregojnë interes të madh, kështu që ata janë të informuar në të gjitha mënyrat e mundshme. Një numër i të anketuarve nuk janë të njoftuar me mundësitë e informacionit.

Duhet të theksohet se një numër i vogël informatash janë në dispozicion për banorët e tanishëm dhe të mëparshëm të Kosovës, si dhe banorët e vendeve fqinje që kanë qenë në lidhje familjare apo miqësore me personat e zhdukur ose personat që i kërkojnë ata.

Është me rëndësi të madhe t'u sigurohet qasje këtyre personave në informacione mbi rezultatet e arritura në kërkimin e personave të zhdukur, si dhe të paraqesin raporte periodike për publikun.

9. A keni dëgjuar për Koalicionin KOMRA?

518 responses




37.3% e të anketuarve kishin dëgjuar për Koalicionin KOMRA, ndërsa 7.5% nuk ishin të sigurt. Shumica e të anketuarve, përkatësisht, 55% nuk kishin dëgjuar për KOMRA.

Këto rezultate tregojnë se një fushatë e planifikuar mirë mediatike është ende e nevojshme për të njohur qytetarët me ekzistencën dhe punën e KOMRA.

10. A e dini me çka merret KOMRA?

518 responses



Sipas rezultateve të marra, numri më i madh i të anketuarve, 54.5% e tyre nuk janë të njoftuar me atë që merret KOMRA, 28.8% janë të njoftuar, ndërsa 15.2% nuk janë të sigurt.

KOMRA është një shkurtesë e emrit të plotë të Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish-RSFJ-së nga 1 janari 1991 deri më 31 dhjetor 2001.

Pajtimi në ish vendet e ish-RSFJ-së

Me gjetjen e të vërtetës dhe vërtetimit të fakteve për personat e zhdukur e të plagosur në luftërat e ish-RSFJ

Të drejtat e njeriut dhe personat e zhdukur/të vrarë

Duke shkelur të drejtat e njeriut dhe përcaktimin e krimeve të luftës të kryera

NGOs

Nuk e di

Komisioni për Krimet e Luftës dhe Shkeljet e të Drejtave të Njeriut, i cili merret me regjistrimin e viktimave gjatë luftës, shkaqet e vdekjes, vendet e burgimit dhe torturave, marrjen në pyetje të viktimave dhe të ngjashme


Në këtë kuptim, dallohet komenti i një të anketuari:

“KOMRA është shkurtesë e emrit të plotë të Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish-RSFJ-së nga 1 janari 1991 deri më 31 dhjetor 2001.”

Përgjigjet e marra tregojnë se qëndrimet e këtij numri të vogël të të anketuarve janë kryesisht të ngjashëm, por edhe kritikë për çështjen e informacionit për të njëjtën gjë. Pakënaqësia buron nga problemet dhe pasojat e shumta të dukshme me të cilat përballen qytetarët gjatë konfliktit, vetë pesha e temës së trajtuar nga Koalicioni, si dhe mungesa e informacionit themelor që qytetarët duhet të marrin nga mediat.

11. A dini për ndonjë nga aktivitetet e kryera nga KOMRA?

518 responses



Pastaj, sipas rezultateve të fituara, mund të vërejmë se vetëdijësimi i qytetarëve për aktivitetet e kryera nga Koalicioni për KOMRA është në një nivel shumë të ulët, vetëm 14.9% e të anketuarve janë të njoftuar me aktivitetet, ndërsa 68.7% nuk e dinë se cilat aktivitetet janë në pyetje, dhe 16.4% nuk janë të sigurt.

11a. Nëse përgjigja është PO, cekni aktivitetet:

79 responses

Hulumtimi

I kanë mbledhur nënshkrimet e qytetarëve për formimin e REKOM.

Kryesisht iniciimi i pjesëmarrjes së qeverive të të gjitha vendeve që mungonin dhe shënimi i datës së vuajtjeve

HLc

Regional Level Networking, Reports, Campaigns, Petitions, Debates, Forums, Social Based Dialogues, Art Projects, Sports (Marathons), Scripts & Writings, Books, Prints, Documents and Publications, etc.

Organizimi i debatave të ndryshme, forumeve për të drejtën tranzicionale...

Forume në temën e të drejtave të njeriut dhe të të zhdukurve


Nuk e di

Idiotizëm

Veçojmë një nga komentet e mëposhtme nga ata që janë të njoftuar me aktivitetet e KOMRA: "Kryesisht iniciimi i pjesëmarrjes së qeverive të të gjitha vendeve që ka munguar dhe duke shënuar datën e vuajtjeve."

12. A jeni të njoftuar se ekzistojnë shoqatat e familjeve të të zhdukurve?


518 responses



Shumica e të anketuarve - 83.6% janë të vetëdijshëm për ekzistimin e shoqatave të familjeve të të zhdukurve, një përqindje e vogël, 9% e tyre nuk janë, ndërsa 7.5% nuk janë të sigurt. Një numër i madh i personave të zhdukur, si dhe rastet e shumta të pazgjidhura, krijuan nevojën e ribashkimit të këtyre familjeve në mënyrë që të ndikojnë që hetimi të përmirësohet dhe të përshpejtohet, si dhe për mbështetje të ndërsjellë.

13. A e dini me çfarë aktivitete merren këto organizata?


518 responses



37.3% të të anketuarve ishin njohur me aktivitetet e shoqatave të përmendura, dhe 37.3% nuk janë të sigurt. 23.9% e të anketuarve deklaruan se nuk ishin të njohur me aktivitetet e shoqatës.


13a. Nëse përgjigja është PO, cekni aktivitetet:

178 responses



14. Sipas mendimit tuaj, a janë respektuar plotësisht standardet e të drejtave të njeriut në identifikimin e të zhdukurve?

510 responses




Shumica e të anketuarve për pyetjen e mësipërme kanë dhënë përgjigje negative. Deri në 68.2% e tyre nuk mendojnë se standardet e të drejtave të njeriut respektohen plotësisht në përcaktimin e të zhdukurve, ndërsa 31.8% nuk janë të sigurt.

Kjo është një tjetër nga një sërë pakënaqësishë të shprehura nga të anketuarit tanë për punën e institucioneve përgjegjëse dhe respektimin e pamjaftueshëm të të drejtave të njeriut.

15. Sipas mendimit tuaj, a është përcaktuar deri tani numri i saktë i personave të zhdukur?


512 responses



Kur bëhet fjalë për numrin e personave të zhdukur, 74.2% e të anketuarve besojnë se numri i saktë i personave të zhdukur nuk është përcaktuar, ndërsa vetëm një numër i vogël mendojnë se është përcaktuar - 3.1, kurse 22.7% e tyre nuk janë të sigurt.

16. Në çfarë mase është i nevojshëm kërkimi i një zgjidhje për secilin rast individual të një personi të zhdukur?

512 responses




Përqindja më e madhe e të anketuarve - 75.8% besojnë se është kryesisht e nevojshme të gjendet një zgjidhje për secilin rast individual.

Nga ana tjetër, një numër i caktuar i të anketuarve tregojnë indiferencë, moskuptim të problemit dhe rëndësisë së zgjidhjes së çështjeve individuale dhe mendojnë se nuk është e rëndësishme në një farë mase.

Familjet e personave të zhdukur sigurisht meritojnë çdo përpjekje për të zgjidhur të gjitha rastet, në mënyrë që të plotësojnë drejtësinë dhe të sigurojnë paqe për ata që kërkojnë të vërtetën.

17. Në çfarë mase është e rëndësishme të zgjidhet çështja e personave të zhdukur?

512 responses




Një numër i madh i të anketuarve besojnë se zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur ka një rëndësi të madhe - 84.8%.

Ky rezultat është padyshim inkurajues, duke pasur parasysh dhimbjen e familjeve dhe miqve të viktimave që presin drejtësi për dekada të tëra.

18. A është zhdukur dikush i afërt i juaji gjatë konflikteve të fundit në Kosovë?


512 responses



24.2% e të anketuarve deklaruan se kishin marrëdhënie të ngushta me personat nga Kosova që janë listuar si të zhdukur, ndërsa 69.7% thonë se nuk kishin dikë të afërt që u ishte zhdukur.

18a. Nëse përgjigja është PO, a është sqaruar ai rast?

134 responses




Përgjigjet e një numri të madh të të anketuarve tregojnë se asnjë rast i një personi të zhdukur i afërt i tyre nuk është zgjidhur, ndërsa një përqindje e vogël deklaroi se në një farë mase këto raste janë apo nuk janë sqaruar. Rreth 73.7% të rasteve të cituara nga të anketuarit nuk janë zgjidhur fare.

Rezultatet e marra janë shumë shqetësuese, gjë që flet për faktin se është arritur shumë pak edhe pas 20 vitesh nga konflikti. Nëse vazhdojnë praktika të ngjashme në të ardhmen e afërt, shanset për zgjidhjen e çështjeve do të jenë gjithnjë e më të pakta.

19 A e njihni ndonjë person/a që i është zhdukur ndonjë i afërt/ë gjatë konflikteve të fundit në Kosovë?


511 responses



Deri në 71.2% e të anketuarve njohin dikë që është në kërkim të një personi të afërt i cili është regjistruar si i zhdukur në konflikt në Kosovë, ndërsa 18.2% thonë se nuk njohin askend.

19a. Nëse përgjigja është PO, a është/janë ai/ato rast/e i zgjidhur?


368 responses



Fatkeqësisht, përgjigjet për këtë çështje tregojnë një përqindje shumë të vogël të çështjeve të zgjidhura. Vetëm 6% e të anketuarve thanë se e njihnin dikë që po kërkonte një person të afërt dhe se çështja e këtyre zhdukjeve ishte zgjidhur, 8% thanë që raste të tilla ishin zgjidhur pjesërisht, ndërsa shumica e rasteve, siç thanë të anketuarit, nuk janë zgjidhur - madje 64%.

20. Në përgjithësi, në çfarë mase janë zgjidhur ato raste të të zhdukurve (të cilat konsiderohen publikisht si të zgjidhura)?

512 responses



Kur bëhet fjalë për besimin dhe sinqeritetin e institucioneve, si dhe informacionet që ata plasojnë në publik, përgjigjet tregojnë se shumica e të anketuarve i marrin këto informata me rezerva, dhe dyshojnë në rëndësinë e tyre. 36.4% e të anketuarve besojnë se informacionet që japin institucionet janë në një masë të saktë, dhe 16.7% deklaruan se janë në një masë të pasaktë. Vetëm një përqindje e vogël e të anketuarve besojnë se çështjet që konsiderohen të zgjidhura janë vërtet të zgjidhura. 18.2% e të anketuarve nuk janë të sigurt.

21. Deri në çfarë mase janë të angazhuar politikanët në zgjidhjen e çështjes së të zhdukurve?

512 responses




Mosbesimi tek politikanët është i madh. Asnjë nga të anketuarit nuk konfirmoi angazhimin e plotë të politikanëve vendorë në zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur. 22.7% mendojnë se janë në një masë dhe 9.1% se nuk janë të angazhuar në një masë. Përqindja më e madhe e të anketuarve mendon se politikanët nuk janë angazhuar fare - deri në 57.6%.

Duke pasur parasysh që ka shumë pak raste të zgjidhura, një qëndrim i tillë nuk është befasues.

22. A kanë ndërmarrë institucionet vendore të gjitha masat e nevojshme për të zbuluar fatin e personave të zhdukur?

512 responses




51.5% e të anketuarve janë të pakënaqur me punën e institucioneve vendore, të cilët besojnë se nuk kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të zbuluar fatin e personave të zhdukur. Një përqindje më e vogël e të anketuarve i mbështesin ata, ku besojnë se institucionet kanë ndërmarrë masat e nevojshme. 10.6% e të anketuarve deklaruan se janë ndërmarrë disa masa, ndërsa 9.1% besojnë se nuk kanë ndërmarrë.

As këto rezultate nuk janë befasuese, duke pasur parasysh që kjo çështje nuk është prioritet në rendin e ditës, madje as nga institucionet ekzistuese në Kosovë.

23. A kryen qeveria juaj lokale ndonjë aktivitet që synon zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur?

512 responses



Për këtë çështje, pak ka përgjigje pozitive nga të anketuarit. 48.5% e tyre besojnë se qeveritë lokale nuk kanë ndërmarrë aktivitete të caktuara që synojnë zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur, dhe e njëjta përqindje nuk e di nëse kanë ndërmarrë ndonjë aktivitet.

Përgjigjet e marra çojnë në përfundimin se qeveritë lokale, edhe nëse kryejnë ndonjë veprimtari në lidhje me zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur, vetëm një përqindje e vogël e qytetarëve janë të vetëdijshëm për këtë.

23a. Nëse përgjigja është PO, listoni aktivitetet:

38 responses

Shënimi i ditës së të zhdukurve

Nuk është


Të sillen fajtorët para drejtësisë dhe të gjinden dhe të varrosen personat e zhdukur

Aktivitetet që të anketuarit besojnë se vetëqeverisjet lokale po kryejnë janë shënimi i ditës së të zhdukurve dhe sjellja e autorëve para drejtësisë.

Nga bashkëngjitja mund të shihet se qytetarët nuk kanë vetëdije të zhvilluar, as informacion mbi punën e vetëqeverisjes lokale kur bëhet fjalë për zgjidhjen e rasteve të personave të zhdukur.

24. A ka ndërmarrë bashkësia ndërkombëtare gjitha masat e duhura në lidhje me çështjen e personave të zhdukur?


514 responses



Të anketuarit janë kryesisht të pakënaqur me punën e bashkësisë ndërkombëtare. Një numër i madh, 41.8% e tyre, besojnë se bashkësia ndërkombëtare nuk ka ndërmarrë fare masat e nevojshme në lidhje me personat e zhdukur. 22.4% e të anketuarve mendojnë se në një masë kanë ndërmarrë, 11.9% mendojnë se nuk kanë ndërmarrë hapa, ndërsa pjesa tjetër nuk janë të sigurt që janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme.

25. A ekziston bashkëpunimi i ndërsjellë në mes të palës shqiptare dhe serbe në lidhje me zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur?


514 responses



32.8% e të anketuarve besojnë se ekziston një bashkëpunim ndërmjet palëve serbe dhe shqiptare për zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur, ndërsa 11.9% janë të mendimit se nuk ekziston bashkëpunimi sa duhet. Nuk ka dyshim se bashkëpunimi është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të dy anët, në mënyrë që të qartësohen sa më shpejt rastet e personave të zhdukur. Sidoqoftë, 28.4% e të anketuarve nuk janë të sigurt se ekziston, dhe 25.4% mendojnë se nuk ekziston fare, sepse situata politike dhe ngadalësimet dhe / ose ndërprerja e negociatave midis Beogradit dhe Prishtinës nuk kontribuojnë në zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur.

26. Sipas mendimit tuaj, a duhet të përmirësohet bashkëpunimi midis palës serbe dhe shqiptare?


514 responses



Përqindja më e lartë - 71.6% e të anketuarve janë të vetëdijshëm për rëndësinë e përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet palës serbe dhe shqiptare, në mënyrë që të arrihen rezultatet më të mira të mundshme në zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur. Vetëm 10.4% e të anketuarve besojnë se ky bashkëpunim nuk duhet të përmirësohet.

27. Në çfarë mase është i rëndësishëm dialogu i komuniteteve në Kosovë për zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur?


514 responses



Dialogu ndërmjet komuniteteve në Kosovë është gjithashtu i një rëndësie të madhe në adresimin e çështjes së të zhdukurve. 62.7% e të anketuarve besojnë se mund të arrihen rezultate më të mira me një dialog të tillë, dhe 19.4% e të anketuarve pajtohen deri diku. Një përqindje më e vogël e të anketuarve besojnë se dialogu midis komuniteteve është deri diku ose aspak i rëndësishëm.

28. Sipas mendimit tuaj, a duhet të jetë çështja e personave të zhdukur temë bisedimesh në mes të përfaqësuesve të Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel?


514 responses



Se çështja e personave të zhdukur duhet të jetë temë e diskutimit midis Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel, pajtohen 67.2%, në një farë mase pajtohen 19.4% e të anketuarve. Shumë pak të anketuar nuk pajtohen që kjo temë duhet të jetë pjesë e bisedimeve në Bruksel. Ky rezultat pritet, pasi qytetarët janë të vetëdijshëm se çështjet e rëndësishme, veçanërisht çështja e personave të zhdukur, mund të zgjidhen vetëm nëse ekziston vullnet politik i një niveli të lartë dhe angazhim i bashkësisë ndërkombëtare.

29. Në cilat institucione / organizata keni më shumë besim kur bëhet fjalë për zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur? (Mundë të rrethoni më shumë përgjigje)

514 responses




Grafiku tregon se besimi më i madh ishte shprehur në shoqatat e personave të zhdukur nga ana e të anketuarve. Shoqatat janë përfshirë në mënyrë aktive në kërkimin e personave të zhdukur, kryesisht të afërm ose anëtarët e familjes, dhe ky është aktiviteti i tyre primarë. Është logjike që roli i shoqatave është shumë i rëndësishëm dhe që të gjitha institucionet dhe organizatat në Kosovë, vendore dhe ndërkombëtare, duhet të mbështesin shoqatat e familjeve të personave

të zhdukur. Besim i madh u shfaq gjithashtu ndaj organizatave joqeveritare dhe komunitetit ndërkombëtar.

30. Sipas mendimit tuaj, cili institucion/organizatë duhet të merret me çështjen e personave të zhdukur?


328 responses



Sipas të anketuarve, institucionet që duhet të merren me çështjen e personave të zhdukur janë qeveritë dhe organet qeveritare, dhe më pas duhet të kyçet siguria e shtetit, Ministria e punëve të brendshme, organet e veçanta të punës, vetëqeverisjet lokale, shoqatat dhe të tjerët duhet të përfshihen në mënyrë të barabartë. Nëse përfshihen të gjitha institucionet, shanset për të zgjidhur fatin e të zhdukurve do të jenë më të larta.


31. Sipas mendimit tuaj, çka është e nevojshme të bëhet për të zgjidhur çështjen e personave të zhdukur? (Mundë të rrethoni më shumë përgjigje)

514 responses



32. Sipas mendimit tuaj, çfarë janë gjasat që në një të ardhme të afërt të zgjidhet çështja e personave të zhdukur në tërësi?

514 responses



Fatkeqësisht, të anketuarit nuk janë optimistë për zgjidhjen e fatit të personave të zhdukur, 49.3% mendojnë se nuk do të zgjidhet fare, dhe 20.9% se do të zgjidhet deri diku dhe 17.9% se nuk do të zgjidhet në një farë mase. Ekziston një përqindje e vogël e atyre që besojnë se kjo çështje ndonjëherë do të zgjidhet plotësisht.

Rezultatet e tilla sigurisht nuk janë befasisuese, duke pasur parasysh se kanë kaluar më shumë se 20 vjet nga konflikti në Kosovë, dhe fati i shumë personave të zhdukur ende nuk është sqaruar.

33. Komente shtesë nëse keni

198 responses

Për 20 vjet, bashkësia ndërkombëtare ju ka toleruar politikanëve korrupsionin e pakuptueshëm, ata kanë plaqitur tërë Kosovën, pa asnjë mëshirë dhe dhembshuri ndaj popullit të shtypur, të gjitha me pëlqimin e heshtur të bashkësisë ndërkombëtare. Rast ligjor katastrofik i korruptuar dhe jofunksional. Historia nuk do t'ju falë kurrë.

Ironia është se politikanët që ishin pjesëmarrës në rrëmbimet e serbëve dhe krimet kundër tyre flasin për çështjet e të zhdukurve. Ata mund të japin përgjigjen se ku janë këta njerëz

Një tjetër çështje, shqiptarët po flasin për 1.400 njerëz të zhdukur, ndërsa fshehin që një e treta e tyre janë serbë!

Nuk mendoj se ekziston një e vërtetë universale dhe as nuk është parakusht për pajtim. Në luftë ekzistojnë të gjitha anët, madje edhe dy të vërteta. Në luftën e Kosovës ka edhe një të tretë, e përfaqësuar nga bashkësia ndërkombëtare. Ajo njësoj kishte motivet e saj për të mbuluar dhe trilluar krimet e luftës

Sa më parë të zgjidhen këto çështje

Thankfull to all the individuals and collective societies who are laying forward all their energies in syngery with one - another in order to find the final truth about the Missing Persons regardless of the origins and/or their backgrounds

Nuk kamë

Gjërat nuk do të ndryshojnë përderisa janë në institucione/në pushtet PDK, AAK, SNS, SRS, dhe të tjerët. Këto janë elitat të cilat kmbajnë gjakun në duart e tyre.

N/A

Për t'iu drejtuar më shumë policisë së Kosovës për të ndihmuar në gjetjen e personit me të cilin policia pati kontaktin e fundit

Anketë e shkëlqyer

Çështja e personave të zhdukur është një çështje e madhe për çdo individ që është i lidhur me raste të tilla, më saktë, ka të afërm që janë zhdukur dhe veçanërisht ata rastet e të cilëve nuk janë zgjidhur (fare). Për të zgjidhur çështjen e personave të zhdukur, unë personalisht besoj se është e DREJTA e të gjithë atyre që humbën dikë në luftë.

Zakonisht, dikush mund të mendojë se drejtësia vjeni kur ata që janë përgjegjës edhe përgjigjen, por në shumë raste, as eshtrat e shumë personave të zhdukur nuk u gjetën, dhe gjetja e tyre, besoj, është një arritje në vetvete dhe gjetje e domosdoshme e atyre që janë përgjegjës. Po, këtu nisemi nga supozimi se personat e zhdukur janë të vdekur

Sikurse e thashë, zgjidhja e sa më shumë rasteve është e drejtë e personave të afërt të tyre, e më pak i çështje politike - edhe pse edhe politika duhet të merret me këto çështje.

Nuk kamë

Angazhim më i madhë i shtetit, shoqatave, OJQ-ve....

Sa i përket komenteve përfundimtare në anketim, të anketuarit lanë një numër të madh të komenteve, më saktësisht, pothuajse çdo i anketuar ka lënë një koment. Në këtë studim janë dhënë gjithsej 198 komente përfundimtare. Një i anketuar ka komentuar se është e vështirë të pritët që çështja e personave të zhdukur të zgjidhet për sa kohë që palët që ishin pjesë e konfliktit janë në pushtet në Beograd dhe Prishtinë dhe mbajnë përgjegjësi të madhe për viktimat dhe personat e zhdukur në Kosovë.

Gjithashtu, disa prej komentuesve treguan mosbesim dhe jotolerancë ndaj organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare në Kosovë, duke i akuzuar ata për njëanshmëri. Dhe në fund, shumica e komenteve shkojnë në drejtim të nevojës për të zgjidhur sa më shpejt çështjen e personave të zhdukur dhe në drejtim të bashkëpunimit të nevojshëm midis Beogradit dhe Prishtinës, si dhe mbështetjes së organizatave ndërkombëtare në zgjidhjen e kësaj çështje.

Konkluzionet:

Çështja e personave të zhdukur është ende një problem i madh në Kosovë, megjithëse kanë kaluar dy dekada nga konflikti në Kosovë, i cili ka çuar në atë që fati i shumë njerëzve është i panjohur. Shumë institucione shtetërore, bashkësia ndërkombëtare, shoqatat e të zhdukurve, organizatat joqeveritare merren me këtë çështje, por kjo nuk është e mjaftueshme për të zbuluar fatin e personave të zhdukur. Është me rëndësi të madhe vendosja e bashkëpunimit ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës në zgjidhjen e problemit të përbashkët të personave të zhdukur.

Duke analizuar përgjigjet e sondazhit që morëm nga të anketuarit, arritëm në përfundimin se shumica e njerëzve informohen për këtë temë përmes mediave dhe internetit. Ka pak informacione mbi këtë temë në dispozicion të publikut të gjerë, vetëm një pjesë e vogël është e njohur me aktivitetet e kryera nga Koalicioni për KOMRA. Është e nevojshme të punohet për transparencë dhe informim më të madh të publikut për punën dhe zgjidhjen e secilit rast individual, me çka janë pajtuar shumica e të anketuarve.

Besimi në politikanët, institucionet shtetërore, organizatat ndërkombëtare, qeveritë lokale dhe aktorët e tjerë për zgjidhjen e fatit të personave të zhdukur është i ulët. Mendimin se gjatë përcaktimit të numrit të saktë të personave të zhdukur nuk u respektuan të drejtat themelore të njeriut, që e ndante shumica e të anketuarve, e tregon këtë më së miri. Gjithashtu, të anketuarit zakonisht dyshojnë se po merren të gjitha masat e nevojshme për të zgjidhur çështjet dhe se është i nevojshëm angazhimi shumë më i madh nga ana e të lartë cekurve.

Shoqatës së Familjeve të të Zhdukurve, i është dhënë besimi më i madh, dhe kjo është pranuar si një faktor i rëndësishëm në zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur. Duke pasur parasysh që këta janë njerëzit që kanë interesin më të madh për të zgjidhur sa më shpejt këto raste dhe për të zbuluar fatin e të dashurve të tyre, këto rezultate nuk janë befasuese.

Disa nga të anketuarit kishin njerëz të afërt që janë listuar si të zhdukur ose njohin njerëz që janë në kërkim të anëtarëve të humbur të familjes së tyre. Shumica e këtyre rasteve nuk janë zgjidhur ose janë zgjidhur vetëm pjesërisht, megjithëse kanë kaluar më shumë se 20 vjet nga konflikti i Kosovës. Shumica e të anketuarve nuk besojnë ose kanë humbur shpresën se çështja e të zhdukurve do të zgjidhet ndonjëherë plotësisht, d.m.th. se do të mbetet vetëm numër në disa raporte.

Shumë njerëz pyesin nëse zgjidhja e këtij problemi do të kontribuonte në pajtim ose thjesht të zgjonte kujtime të dhimbshme. Zbulimi i së vërtetës për fatin e të zhdukurve nuk do të jetë i këndshëm për publikun e gjerë dhe mund të çojë në ndarje më të mëdha midis komuniteteve në Kosovë, por sigurisht që është e nevojshme për familjet e atyre sepse ata e meritojnë këtë.